



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e III-të

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja e tretë, dt. 18.03.2008
Salla nr. N.225 ora 13,00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Agim Veliu, Drita Kadriu, Enis Kervan, Memli Krasniqi, Vlora Çitaku, Adem Hajdaraj, Fatmire Berisha, Donika Kadaj-Bujupi dhe Mark Krasniqi, ndërsa mungoi Arsim Rexhepi.

Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Lule Ymeri, Drita Morina dhe Mirjeta Heta.
Në mbledhje prezantuan përfaqësuesi i OSBE-së dhe përfaqësuesi nga presidenca.

Mbledhjen e udhëhoqi Agim Veliu, kryetar i Komisionit.
Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i draft planit të punës së Komisionit për vitin 2008.
3. Shqyrtimi i Projektligjit për provimin përfundimtar dhe të maturës
4. Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

1. Procesvarbali i mbledhjes së kaluar u miratua me vërejtjen e deputetit Adem Hajdaraj lidhur me riformulimin e fjalisë në diskutimin e tij.
2. Shqyrtimi i draft planit të punës së Komisionit për vitin 2008.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës anëtarëve të Komisionit i është shpërndarë një draft plan i punës i hartuar në bazë të strategjisë së programit të punës së Qeverisë.

Kryetari i Komisionit Agim Veliu, i informoi të pranishmit se plani i punës së Komisionit do të varet nga dinamika e punës së Qeverisë, respektivisht ministrive që i mbulon Komisioni, dhe i njejtë mund të pësojë ndryshime nga prioritetet e veprimtarisë së Komisionit.

Adem Hajdaraj kërkoi sqarim lidhur me kohën e mbajtjes së dëgjimeve pubike të parapara sipas planit të punës për këtë vit.

Drita Kadriu në diskutimin e saj tha se projekt planin i punës i hartuar nga muaji mars i këtij viti i plotëson kriteret dhe si të tillë e përkrahë.

Donika Kadaç – Bujupi, shtoi çështjen e problematikës së arsimit të mesëm në zonat rurale posaçërisht për braktisjen e shkollimit të mesëm nga femrat, dhe kërkoi që në objektivat e planit të punës së Komisionit për vitin 2008 të parashihet edhe çështja e arsimit të mesëm që duhet të jetë obligativ.

Kryetari i Komisionit Agim Veliu me këtë rast tha se një ndër prioritetet e Qeverisë për këtë vit është edhe ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm, dhe se kjo çështje do të shqyrtohet dhe debatohet me kohë.

Mark Krasniqi në diskutimin e tij kërkoi që Institucionet të vlerësojnë cilat janë prioritetet që duhet të kryhen këtë vit.

Memli Krasniqi në diskutimin e tij lidhur me planin e punës së Komisionit, shtoi çështjen e Projektligjit për Fuqizimin e Rinisë i cili sipas programit strategjik të Qeverisë parashihet të shqyrtohet gjatë muajit dhjetor, dhe lidhur me këtë kërkoi që të ndërmerren hapa që Ligjet me prioritet të procedohen më herët në Kuvend. Propozim i dytë ka të bëjë me çështjen e shqyrtimit të implementimit të Ligjeve në fuqi, siç është Ligji për të drejtat e autorit, si dhe të kërkojmë nga Qeveria raport për mënyrën e implementimit të ligjeve të miratuara.

Agim Veliu, në vazhdim tha se ndër objektet e veprimtarisë së Komisionit është edhe shqyrtimi i implementimit të Ligjeve të miratuara nga Institucionet, ku parashihen edhe organizimi i dëgjimeve publike, si dhe nuk duhet të mungojë iniciativa për hartimin e një projektligji nga Komisioni dhe çështje tjera që janë në fushëveprimtari të Komisionit.

Plani i punës mund të pësojë ndryshime edhe nga prioritetet e fushëveprimtarisë së Komisionit.

Anëtarët e Komisionit miratuan planin e punës për vitin 2008.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për provimin përfundimtar dhe të maturës.

Kryetari i Komisionit, Agim Veliu kërkoi nga anëtarët e Komisionit të përcaktohen për mënyrën e qasjes së punës në shqyrtimin e projektligjit për provimin përfundimtar dhe të maturës.

Pasi që kërkesat për shqyrtim dhe amendamentim të këtij projektligji janë urgjente propozon që metoda me zgjedhjen e një apo dy referuesve do të ishte më funksionale që do të shpejtonte amendamentimin e tij.

Drita Kadriu, theksoi se lidhur me këtë projektligj do të duhej të organizoheshin disa takime të drejtëpërdrejta apo punëtori në disa qendra të rëndësishme. Lidhur me këtë ajo i prezantoi anëtarëve të Komisionit një formë të organizimit të punëtorive në shtatë komunat ku do të merrnin pjesë disa nga anëtarët e Komisionit, dhe në fund të këtyre punëtorive të hartohen raporte në mënyrë që për së afërmi të merren sugjerimet konkrete.

Donika Kadaj – Bujupi tha se e mirëpret këtë nismë dhe se nga takimet e tilla të drejtëpërdrejta mundësia e informimit dhe kontaktit përmes kategorive në terren është e madhe për shumë çështje të arsimit.

Memli Krasniqi përkrahu formën e propozuar, mirëpo për shkak të kohës së shkurtër të shqyrtimit të projektligjit, mendon se duhet gjetur një formë e kompromisit, ose të organizohet një dëgjim publik apo një formë e komunikimit më e gjërë në mënyrë që të kontribuohet në ligj.

Fatmire Berisha në diskutimin e saj përkrahi idenë e propozuar për takime të drejtëpërdrejta, mirëpo për këto takime do duhej një kohë më e gjatë.

Për shkak të kohës së limituar duhet ti qasemi projektligjit në një formë tjetër, në mënyrë që të formojmë grupe punuese apo referues dhe të përfundojmë me amendamentimin e këtij projektligji.

Kryetari i Komisionit gjithashtu përkrahu formën e prezantuar nga deputetja Drita Kadriu, mirëpo për shkak të kohës së shkurtër së amendamentimit dhe nevojës urgjente për të pasur një ligj të tillë propozoi që në shqyrtimin e këtij të caktohen dy referues.

Kryetari i Komisioni konstatoi që referues të Projektligjit për provimin përfundimtar dhe të maturës të jenë anëtarët e Komisionit Drita Kadriu dhe Fatmire Berisha.

Koha e referimit të referuesve të jetë fundi i muajit mars kur do të shqyrtohen dhe debatohet për amendamentet e propozuara.

Me këtë konstatim u pajtuan anëtarët e Komisionit.

4. Të ndryshme

Mbledhja e ardhshme do të caktohet sipas rrjedhës së punëve të Komisionit.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 14,00

Kryetari i Komisionit,
Agim Veliu